LIGJ
Nr. 20/2014

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E PRIVILEGJEVE DHE IMUNITETEVE TË AUTORITETIT NDËRKOMBËTAR TË SHTRATIT TË DETIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin e privilegjeve dhe imuniteteve të Autoritetit Ndërkombëtar të Shtratit të Detit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8521, datë 24.3.3014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLLI
PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E AUTORITETIT NDËRKOMBËTAR TË SHTRATIT TË DETIT

Shtetet palë në këtë protokoll,

Duke marrë në konsideratë ligjin për detin të Konventës së Kombeve të Bashkuara, i cili themelon Autoritetin Ndërkombëtar të Shtratit të Detit;

Duke sjellë në kujtesë nenin 176 të ligjit për detin, pjesës së Konventës së Kombeve të Bashkuara, parashikon që ky autoritet (institucion) duhet të jetë person juridik dhe ky kapacitet juridik do të jetë i nevojshëm për kryerjen e funksioneve dhe plotësimine qëllimeve të tij.

Neni 177 i ligjit të detit të Konventës së Kombeve të Bashkuara, parashikon që institucioni do të gëzojëtë gjitha privilegjet dhe imunitetet, në territorin e çdo vendi pjesë të kësaj Konvente, të përcaktuara në paragrafin 4, nënparagrafi G, të pjesës XI të Konventës dhe se këto privilegje dhe imunitete të kësaj sipërmarrjeje duhet të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në aneksin IV, neni 13;

Duke pranuar se këto privilegje dhe imunitete të tjera janë të nevojshme për të kryer funksionet e institucionit detar ndërkombëtar;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përdorimi i termave

Me qëllim përdorimi në këtë protokoll:

a) “Autoritetet” do të thotë Autoriteti Ndërkombëtar i Shtratit të Detit.

b) “Konventë” do të thotë Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ligjin për detin, e datës 10 dhjetor 1982.

c) “Marrëveshje” do të thotë marrëveshje lidhur me zbatimin e pjesës së 10-të të Konventës së Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit, të datës 10 dhjetor 1982. Në përputhje me këtë marrëveshje, dispozitat e saj dhe të pjesës së 10-të të Konventës, duhet të interpretohen dhe të zbatohen si një instrument i vetëm; ky protokoll dhe referencat e tij lidhur me Konventën, duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrën e duhur.

d) “Ndërmarrja” është organ i këtij Autoriteti, i parashikuar në Konventë.

e) “Anëtar i Autoritet” do të thotë:

I) çdo shtet palë i kësaj Konvente; dhe

II) çdo shtet ose entitet, i cili është anëtar i Autoritetit mbi baza të përkohshme, në përputhje me paragrafin 12/a të paragrafit 1 të aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

f) “Përfaqësuesit” do të thotë përfaqësuesit, përfaqësuesit alternativë, këshilluesit, ekspertët teknikë dhe

sekretaritë e delegacioneve.

g) “Sekretaria e Përgjithshme” do të thotë Sekretaria e Përgjithshme e Autoritetit Ndërkombëtar të Shtratit të Detit.

Neni 2

Dispozita të përgjithshme

Pa paragjykim të statusit juridik, privilegjet dhe imunitetet që i janë dhënë këtij Autoriteti dhe ndërmarrjes, të përcaktuar në paragrafin 4, nënparagrafin G, të pjesës XI dhe aneksin IV, nenin 13 të Konventës, çdo shtet palë i këtij protokolli duhet të pranojë me Autoritetin dhe organet e tij, përfaqësuesit e anëtarëve të Autoritetit, zyrtarët e Autoritetit dhe ekspertët e misionit të Autoritetit, si edhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në këtë protokoll.

Neni 3

Personaliteti juridik i Autoritetit

Autoriteti do të ketë personalitet juridik. Duhet të ketë aftësinë ligjore:

a) të kontraktojë;

b) të marrë dhe të japë pasuri të tundshme dhe të patundshme;

c)të jetë palë në procedurat ligjore.

Neni 4

Paprekshmëria e kushteve të Autoritetit

Kushtet e Autoritetit duhet të jenë të paprekshme.

Neni 5

Lehtësimet financiare të Autoritetit

1.Duke mos pasur kufizime nga kontrollet financiare, rregulloret apo shtyrjet e afatit të çdo lloji, Autoriteti në mënyrë të lirshme:

a)mund të blejë çfarëdolloj monedhe nëpërmjet kanaleve të kanalizuara, t’i mbajë dhe t’i shpërndajë;

b)mund të menaxhojë fondet, sigurinë, arin, metalet e çmuara apo çfarëdo monedhe dhe llogaritë bankare në çfarëdo monedhe;

c)mund të transferojë fondet, mjetet e sigurisë, arin, monedhat nga një vend në tjetrin, ose brenda vendit dhe të konvertojë çdo monedhë të shteteve të ndryshme.

2.Autoriteti, gjatë ushtrimit të të drejtave, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t’i kushtojë vëmendjen e duhur çdo përfaqësie të qeverisë apo të çdo anëtari të Autoritetit, duke marrë në konsideratë që efekti i këtyre përfaqësive nuk është dëmtues për interesin e Autoritetit.

Neni 6

Flamuri dhe emblema

Autoriteti ka të drejtë të shfaqë flamurin dhe emblemën e tij në godinën dhe makinat e tij për t’u përdorur për qëllime zyrtare.

Neni 7

Përfaqësuesit e anëtarëve të Autoritetit

1. Përfaqësuesit e anëtarëve të Autoritetit, që do të jenë të pranishëm në takimet e organizuara nga Autoriteti gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë udhëtimit të tyre drejt vendit të takimit dhe në kthim, kanë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) Imunitet ndaj proceseve ligjore në lidhje me fjalët e shprehura apo ato të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në zbatim të detyrave të tyre, me përjashtim të rastit që anëtari që përfaqësojnë, heq imunitetin në një rast të veçantë;

b) Imunitet ndaj arrestit apo ndalimit, dhe të njëjtat imunitete apo lehtësime për bagazhet e tyre personale,

sikurse u janë akorduar të dërguarve diplomatikë;

c) Paprekshmëria e të gjitha dokumenteve;

d) E drejta për të përdorur kode dhe për të marrë letra apo korrespondenca nga korrierë apo në zarfe të mbyllura;

e) Përjashtim i tyre dhe i bashkëshortëve të tyre nga kufizimet e emigracionit, regjistrimet e huaja apo detyrimeve të shërbimeve kombëtare në shtetin vizitues apo në shtetin që po kalojnë për të ushtruar funksionet e tyre;

f) Të njëjtat lehtësime në lidhje me kufizimet e shkëmbimit, siç u janë akorduar përfaqësuesve të qeverive të huaja, të gradave të krahasueshme apo misioneve zyrtare të përkohshme.

2. Në mënyrë që përfaqësuesve të anëtarëve të Autoritetit t'u sigurohet liri e plotë e fjalës dhe pavarësi në ushtrimin e detyrave të tyre, do të vazhdojë t'u akordohet imunitet ndaj proceseve gjyqësore, në lidhje me të gjitha veprimet e kryera prej tyre në ushtrim të funksioneve të tyre, pavarësisht se personat përkatës nuk janë më përfaqësues të anëtarëve të Autoritetit.

3. Kur niveli i çfarëdo forme taksimi varet nga rezidenca, periudhat gjatë të cilave përfaqësuesit e vendeve anëtare, që marrin pjesë në takimet e Autoritetit, janë të pranishëm në territorin e një anëtari të Autoritetit për të ushtruar detyrën e tyre, kjo nuk do të konsiderohet si periudhë rezidence.

4. Privilegjet dhe imunitetet nuk u janë dhënë përfaqësuesve të anëtarëve të Autoritetit për përfitim personal të vetë individëve, por për të siguruar ushtrimin e detyrave të lidhura me Autoritetin në mënyrë të pavarur. Për pasojë, një anëtar i Autoritetit ka të drejtë dhe ka për detyrë t'i heqë imunitetin përfaqësuesit të tij, nërast se anëtari i Autoritetit mendon se imuniteti do të pengojë rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim me qëllimin e njëjtë për të cilin imuniteti është akorduar.

5.Përfaqësuesit e anëtarëve të Autoritetit duhet të kenë sigurim të mbuluar kundrejt rreziqeve të treta në lidhje me automjetin që kanë në pronësi, apo që përdoret prej tyre, në përputhje me rregullat dhe ligjet në vendin ku automjeti përdoret.

6. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk janë të zbatueshme midis një përfaqësuesi dhe anëtarëve të Autoritetit, në shtetin ku ai është rezident apo në shtetin ku ai ka qenë përfaqësues.

Neni 8

Zyrtarët

1. Sekretaria e Përgjithshme përcakton kategoritë e zyrtarëve për të cilët janë të zbatueshme dispozitat e paragrafit 2. Sekretaria e Përgjithshme duhet t'ia dorëzojë këto kategori Asamblesë. Më pas, këto kategori duhet t'u transmetohen qeverive të vendeve anëtarëve të Autoritetit. Emrat e zyrtarëve, të përfshirë në këto kategori, duhet t'u bëhen të ditura qeverive të vendeve anëtare.

2. Zyrtarët e Autoritetit, pavarësisht kombësisë së tyre:

a) duhet të jenë imunë ndaj proceseve gjyqësore, në lidhje me fjalët e shprehura apo ato të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në kapacitetin e tyre zyrtar;

b) duhet të jenë imunë ndaj arrestimit apo ndalimit në lidhje me veprimet e kryera në kapacitetin e tyre zyrtar;

c) duhet të përjashtohen nga taksat, të ardhurat nga pagat apo çdo formë tjetër pagese të dhënë nga Autoriteti;

d) duhet të jetë imunë ndaj detyrimeve të shërbimeve kombëtare, në lidhje me shtetet e tyre kombëtare, me kusht që ky imunitet të kufizohet te zyrtarët e Autoritetit, emrat e të cilëve janë vendosur në listën e hartuar nga Sekretaria e Përgjithshme dhe janë aprovuar nga shteti përkatës. Nëse zyrtarë të tjerë të Autoritetit duhet të emërohen për shërbime kombëtare,shteti përkatës, me kërkesë të Sekretarisë së Përgjithshme, duhet të shtyjë përkohësisht afatin për të mos ndërprerë vazhdimësinë e punës;

e) duhet të përjashtohen, së bashku me bashkëshortët e tyre apo të afërmit që varen prej tyre, nga kufizimet emigruese dhe regjistrimet e huaja;

f) duhet t'iu akordohen privilegje të njëjta në lidhje me lehtësimet e shkëmbimit,siç u janë akorduar zyrtarëve me grada të njëjta, të cilët janë pjesë e misioneve diplomatike të qeverive përkatëse;

g) duhet të kenë të drejtë të transportojnë pa paguar taksa, mobiliet dhe sendet e tyre personale kur marrin detyrën në vendin në fjalë;

h) duhet të përjashtohen nga kontrolli i bagazheve personale, vetëm nëse ka baza të forta për të besuar se bagazhi përmban sende që nuk janë për përdorim personal apo sende importi dhe eksporti i të cilave është i

ndaluar me ligj apo i parashikuar nga rregullat izoluese të palës së interesuar dhe në këto raste inspektimi kryhet në prani të zyrtarëve përkatës, dhe në rast se bagazhet janë zyrtare, në prani të Sekretarit të Përgjithshëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar;

i) duhet t'u jepen, së bashku me bashkëshortin dhe të afërmit që varen prej tij, të njëjtat lehtësime për riatdhesimin, si të agjentëve diplomatikë në rast të ndonjë krize ndërkombëtare.

3. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve, të përcaktuara në paragrafin 2, Sekretari i Përgjithshëm apo çdo zyrtar përfaqësues gjatë mungesës së tij në detyrë dhe drejtori i përgjithshëm i ndërmarrjes duhet t'u akordohen të njëjtat privilegje, imunitete, përjashtime dhe lehtësime, si të dërguarve diplomatikë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për veten, bashkëshortin ose bashkëshorten, apo fëmijët në moshë jomadhore.

4. Privilegjet dhe imunitetet nuk u janë dhënë zyrtarëve për përfitim personal, por për të siguruar ushtrimin e funksionevenë mënyrë të pavarur në lidhje me Autoritetin. Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe ka për detyrë të heqë imunitetin e zyrtarëve kur, sipas mendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, imuniteti do të pengojë rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim për interesin e Autoritetit. Në rastin e Sekretarit të Përgjithshëm, Asambleja duhet të ketë të drejtë të heqë imunitetin.

5. Autoriteti duhet të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet përkatëse të anëtarëve të Autoritetit për të lehtësuar administrimin në mënyrë të duhur të drejtësisë, për të siguruar shqyrtimin e rregullave dhe për të parandaluar çdo abuzim në lidhje me privilegjet, imunitetet, lehtësimet, të përmendur në lidhje me këtë nen.

6. Në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit përkatës, zyrtarët e Autoritetit duhet të kenë siguracion për rreziqet e treta në lidhje me automjetin që kanë në pronësi apo që e përdorin.

Neni 9

Ekspertët në mision

1. Ekspertët (përveç zyrtarëve që vijnë për qëllimet e specifikuara në nenin 8), që kanë misione për Autoritetin, duhet t'iu jepen privilegje dhe imunitete sipas nevojës për ushtrimin në mënyrë të pavarur të funksioneve të tyre gjatë periudhës së misioneve të tyre, duke përfshirë kohën që kanë shpenzuar në udhëtimet që kanë kryer në lidhje me misionet e tyre. Kryesisht, duhet t'i akordohet:

a) imunitet ndaj arrestimit apo ndalimit apo të çfarëdolloj konfiskimi të bagazheve të tyre personale;

b) në lidhje me fjalët e shprehura dhe të shkruara, dhe veprimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, imunitet ndaj proceseve ligjore të çdo lloji. Ky imunitet duhet të vazhdojë pavarësisht nga fakti që personi në fjalë nuk është më i punësuar në misionet e Autoritetit;

c) paprekshmëria e dokumenteve;

d) e drejta për të përdorur kode dhe për të marrë letra apo korrespondenca nga korrierë, apo në zarfe të mbyllura, për qëllime komunikimi me Autoritetin;

e) përjashtimi nga taksat në lidhje me rrogën dhe pagat apo çfarëdo forme pagese të kryer nga Autoriteti. Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme midis ekspertit dhe shtetit anëtar të Autoritetit, i cili është shteti nga ai vjen;

f) të njëjtat lehtësime në lidhje me kufizimet e monedhës apo të shkëmbimit, siç u janë akorduar përfaqësuesve të qeverive të huaja për misione zyrtare të përkohshme.

2. Privilegjet dhe imunitetet, që u janë dhënë ekspertëve, jo për qëllime personale të individëve, por për të siguruar ushtrimin në mënyrë të pavarur të detyrave në lidhje me Autoritetin. Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë të heqë imunitetin e ekspertit, kur sipas mendimit të tij, imuniteti pengon rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim për interesat e Autoritetit.

Neni 10

Respektimi i ligjeve dhe i rregullave

Pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet, është detyra e të gjithë individëve, të përmendur në nenet 7, 8 dhe 9, për të respektuar ligjet dhe rregullat e vendeve anëtare të Autoritetit, në territorin e të cilit ata mund të qëndrojnë për të ushtruar detyrat në lidhje me Autoritetin ose në vendet ku ata kalojnë për të ushtruar këto detyra.Ata, gjithashtu, kanë për detyrë të mos ndërhyjnë në çështjet e brendshme të atij vendi anëtar.

Neni 11

Leje kalimi dhe viza

1.Pa paragjykuar mundësinë e Autoritetit për të nxjerrë dokumentet e veta të udhëtimit, shtetet palë të këtij protokolli duhet të njohin dhe të pranojnë lejet e kalimit të Kombeve tëBashkuara të zyrtarëve të Autoritetit.

2.Aplikimet për vizë (kur është e nevojshme), nga zyrtarët e Autoritetit, duhet të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur. Aplikimet për vizë (kur është e nevojshme), nga zyrtarët e Autoritetit, të cilët kanë leje kalimi të Kombeve të Bashkuara, duhet të shoqërohen nga një dokument që konfirmon që ata udhëtojnë për qëllime pune në lidhje me Autoritetin.

Neni 12

Marrëdhënia midis marrëveshjes së zyrave qendrore dhe protokollit

Dispozitat e këtij protokolli duhet të jenë plotësuese të dispozitave të marrëveshjes së zyrave qendrore. Nëse dispozitat e këtij protokolli kanë objekt të njëjtë me Marrëveshjen, ato do të trajtohen si plotësuese të njëra-tjetrës sa herë të jetë e nevojshme, në mënyrë që të dyja dispozitat të jenë të zbatueshme dhe asnjëra prej tyre të mos kufizojë efektin e tjetrës; por nëse ka konflikt, do të merren për bazë dispozitat e Marrëveshjes.

Neni 13

Marrëveshje plotësuese

Ky protokoll nuk duhet të kufizojë apo të paragjykojë në asnjë formë privilegjet dhe imunitetet, të cilat i janë dhënë Autoritetit nga çdo anëtar i tij, prej tij, me qëllim vendndodhjen në territorin e vendit anëtar të zyrave qendrore të Autoritetit apo qendrave rajonale ose zyrave. Ky protokoll nuk duhet të parandalojë përmbylljen e marrëveshjeve plotësuese midis Autoritetit dhe çdo anëtari të Autoritetit.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në lidhje me zbatimin e privilegjeve dhe imuniteteve të dhëna nga ky protokoll, Autoriteti duhet të nxjerrë dispozita të përshtatshme për zgjidhjen e duhur të:

a) mosmarrëveshjeve të karakterit të një ligji privat të një shteti palë të Autoritetit;

b) mosmarrëveshjet që përfshijnë çdo zyrtar të Autoritetit apo çdo ekspert në mision për Autoritetin, i cili për arsye të pozicionit të tij zyrtar gëzon imunitet, nëse imuniteti nuk i është hequr nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Çdo mosmarrëveshje midis Autoritetit dhe anëtarëve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij protokolli, e cila nuk është zgjidhur me këshillim, negociata apo mënyra të tjera të pranuara për zgjidhje brenda tre muajve pas kërkesës së bërë nga njëra prej palëve në mosmarrëveshje, duhet t'i përcillet panelit të tre arbitrave me kërkesë të njërës prej palëve për një vendim final dhe detyrues:

a) Një i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm, një i emëruar nga pala tjetër në mosmarrëveshje dhe i treti, i cili do të jetë drejtuesi i panelit do të zgjidhet nga dy arbitra;

b) Nëse të dyja palët nuk kanë emëruar një arbitër, brenda dy muajve nga emërimi i gjykatësit nga pala tjetër, Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare për Ligjin e Detit duhet të kryejë emërimin. Nëse të dy gjyqtarët e parë nuk bien dakord me emërimin e gjykatësit të tretë, brenda tre muajve pas emërimit të dy gjykatëse të parë, gjykatësi i tretë do të zgjidhet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Ligjit për Detin me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm apo të palës tjetër në mosmarrëveshje.

Neni 15

Nënshkrimi

Ky protokoll duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Autoritetit në zyrat qendrore të Autoritetit Ndërkombëtar të Shtratit të Detit, në Xhamajka, nga data 17 gusht 1998 deri në datën 16 gusht 2000, në zyrat qendrore të Kombeve të Bashkuara, në Nju-Jork.

Neni 16

Ratifikimi

Ky protokoll është subjekt ratifikimi, aprovimi dhe miratimi. Instrumentet e ratifikimit, aprovimit dhe miratimit, duhet të përcaktohen me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 17

E drejta e përdorimit

Ky protokoll duhet të jetë i hapur për t'u përdorur nga të gjithë anëtarët e Autoritetit. Instrumentet për përdorim do të përcaktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 18
Hyrja në fuqi

1.Protokolli duhet të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, aprovimit, miratimit dhe përdorimit.

2.Për çdo anëtar të Autoritetit që ratifikon, aprovon dhe pranon këtë protokoll apo e përdor pas depozitimit të instrumentit të 10-të të ratifikimit, aprovimit, pranimit, përdorimit, ky protokoll duhet të hyjë në fuqi në ditën e trembëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, aprovimit, pranimit dhe përdorimit.

Neni 19
Zbatimi i përkohshëm

Shteti që ka për qëllim të ratifikojë, aprovojë, pranojë dhe përdorë këtë protokoll, duhet të njoftojë në çdo kohë depozituesin që do të zbatojë përkohësisht protokollin për një periudhë jo më të gjatë se dy vjet.

Neni 20
Denoncimi

1. Një shtet palë mund t'i drejtohet me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të denoncuar këtë protokoll. Denoncimi duhet të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit, vetëm nëse njoftimi përcakton një datë më vonë.

2. Denoncimi nuk duhet të ndikojë në asnjë formë në punën e shtetit palë për të plotësuar, të shprehur në këtë protokoll, që do të jetë subjekt i së drejtës ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga protokolli.

Neni 21
Depozituesi

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të jetë depozituesi i këtij protokolli.

Neni 22
Tekstet autentike

Tekstet në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të këtij protokolli janë tërësisht të njëjta.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e autorizuar kanë nënshkruar këtë protokoll.

Ky dokument është i hapur për t'u nënshkruar, në Kesington, nga data 17 gusht 1998, në një kopje të vetme origjinale në gjuhët arabe, kineze, angleze, ruse dhe spanjolle.